



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**ZL Anr. 533/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e Gent Begollit, bartës i listës së subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Prishtinë, për shkak të keqpërdorimit të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 31.10.2017, mori këtë:

## **V E N D I M**

**HUDHET** si e palejuar ankesa: ZLA.nr 533/2017 e datës 27.10.2017 e parashtruar nga Gent Begolli, bartës i listës së subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Prishtinë, paraqitur për shkak të keqpërdorimit të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 27.10.2014, e parashtruar nga Gent Begolli, bartës i listës së subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Prishtinë, me të cilën kërkojnë hapjen e kutive dhe rinumërimin e votave për anëtar të Kuvendit Komunal në Prishtinë, pasi që sipas tyre, një numër i konsiderueshëm i kandidatëve të AAK-së, kanë shfaqur pakënaqësi lidhur me numërimin e votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

Më tej parashtruesi i ankesës ka shtuar se janë të vetëdijshëm që kërkesa e tyre është e parakohshme por për arsye të pakënaqësive të shumta nga kandidatët e AAK-së lidhur me numërimin e votave, dhe për korrektësi ndaj tyre dëshirojnë të veprojnë para afateve ligjore. Po ashtu deklarojnë se do ti ofrojnë PZAP-it faktet e nevojshme ditët në vijim.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

## **Ankesa është e pa lejuar**

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar në ankesë përkitazi me keqpërdorimin e votave në Komunën e Prishtinës, për faktin se shkeljet që ndërlihen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi për shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së ankuesit Gent Begolli, në emër të subjektit politik AAK, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL Anr. 533/2017 me datën 31.10.2017



**Kryesues i Panelit**

**Hasan Shala**

**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa.*